

AKT  2%



A_{RT} - K_{ULTURË} - T_{RASHËGIMI}

#2021-2025

Partia Demokratike

PROGRAM KOMBËTAR AKT  2% ART KULTURË TRASHËGIMI 2021-2025

Pasqyra përmbajtëse

1. KONTEKSTI NË TË CILIN HARTOHET PROGRAMI AKT 2%	5
1.1 Quo vadis kultura në Shqipëri 2013-2021?	
2. PROGRAMI KOMBËTAR AKT-2%.....	10
3. PARIMET MBI TË CILAT ËSHTË HARTUAR PROGRAMI KOMBËTAR AKT 2%.....	11
3.1 decentralizimi	
3.2 depolitizimi	
3.3 dimensionimi ekonomik i kulturës	
3.4 ekuilibër mes investimit në kulturën statike dhe asaj dinamike	
3.5 kultura si e drejtë humane	
3.6 promovimi i identitetit kulturor të komuniteteve	
3.7 konteksti evropian	
4. MISIONI.....	15
5. VIZIONI.....	15
6. QËLLIMI STRATEGJIK.....	15
7. OBJEKTIVAT POLITIKE TË PROGRAMIT KOMBËTAR AKT 2%.....	17
7.1 Arti dhe kultura një drejtë humane dhe faktor themeltar për një shoqëri më të shëndetshme, më tolerante dhe gjithpërfshirëse	
7.2 Një gjuhë, një mendim, një kulturë, një komb.....	17
7.3 Komunizmi në kryqëzimin mes kujtesës dhe historisë, të vërtetës dhe interpretimit.....	19
7.4 Integrimi kulturor i Shqipërisë përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë....	21

Pasqyra përmbajtëse

8. OBJEKTIVA STRATEGJIKE.....23


- 8.1 Hartimi i një mjedisi ligjor që garanton zbatimin e këtij programi për reformim funksional të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore duke specifikuar këtu rishikim dhe hartim në standardet europiane të të gjithë spektrit të paketës ligjore.
- 8.2 Rishikim, përmirësim dhe lehtësim të politikës fiskale në të gjithë spektrin e industrisë kreative.
- 8.3 Krijimi dhe themelimi i institucioneve të reja, rikonceptimi dhe ristrukturimi i institucioneve ekzistuese nga ana ligjore dhe infrastrukturore si domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e artit kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

9. PROGRAMET MBËSHTETËS.....31

- "Thesaret e Shqipërisë"
- "Urat të Kulturës Kombëtare"
- "Mendje kurioze, kritike, kreative"
- "ART -bank"
- "RINFOND"

10. SFIDA.....33

- Liberalizimi i tregut të artit dhe kulturës
- Arti dhe kultura në epokën digjitale
- Punësimi i të rinjve
- Kuota gjinore
- Artistë nga grupet e marginalizuara



KONTEKSTI MBI TË CILIN HARTOHET KY PROGRAM





1. Konteksti mbi të cilin hartohet ky program

Arti, liria dhe kreativiteti mund të sjellin në kulturën e një kombi ndryshime më të vlefshme dhe më të shpejta se politika, por nëse politika në këtë trinom ka hequr lirinë atëherë, pas mbetet vetëm pyetja:

1.1 Quo vadis kultura në Shqipëri 2013-2021?

Mungesa e vullnetit politik për vendimmarrje të drejta në shërbim të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore gjatë viteve 2013-2020, ka penguar dinamikën zhvilluese të këtij sektori të pazëvendësueshëm për ndikimin e tij në mirëqenie, zhvillim dhe edukim, e fatkeqësisht në disa fusha ka dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme vlera të rëndësishme të trashëgimisë, kulturës dhe historisë sonë kombëtare.

Vendimmarrja në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore gjatë

periudhës 2013-2020 nuk reflektoi dhe nuk u mbështet asnjëherë mbi angazhimet politike dhe premtimet elektorale të bëra nga Partia Socialiste në dy programet parazgjedhore prezantuar respektivisht në vitin 2013 dhe në vitin 2017.

Ministria e Kulturës edhe në "Strategjinë për Artin dhe Kulturën 2019-2025" pas më shumë se shtatë vite të qeverisjes së Partisë Socialiste, riciklon të njëjtat sfida dhe prioritete, të njëjtat qëllime dhe objektiva, pothuaj të

njëjtat reforma që duhet të kryhen në këtë sektor. Mungesa e vizionit, mungesa vullnetit për të reflektuar mbi çfarë është bërë gabim, analizat dhe arsyet, tregon paaftësinë, papërgjegjshmërinë por mbi të gjitha dështimin e plotë për të kryer reforma të vlefshme në kulturë, art dhe trashëgimi si një prioritet për ruajtjen e identitetit tonë kombëtar përballë një diversiteti kulturor global që gjallon e zhvillohet me shpejtësi, por edhe si një parakusht për një realitet social më tolerant e më gjithpërfshirës, për të cilin sot

kanë aq shumë nevojë shqiptarët. Referuar të dhënave gjatë shtatë viteve e fundit 2013-2020 **buxheti** për Ministrinë e Kulturës ka qenë pothuaj i pandryshueshëm duke zënë një mesatare konstante **0.68 ~ 0,7%** të buxhetit të shtetit duke u radhitur e fundit për nga vlera e buxhetit e saj në krahasim me ministrinë e linjës. Ministria e Kulturës në varësi të saj ka 28 institucione të fushës së artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, të cilat përdorin 50% të buxhetit të kësaj ministrie kryesisht për rroga dhe sigurime shoqërore. Gjithashtu referuar të dhënave për rajonin buxhetet për sektorin e kulturës janë :

- **Republika e Serbisë, 3% të buxhetit vjetor ose 112 mln €**
- **Republika e Maqedonisë së Veriut , 3% të buxhetit vjetor - 69 mln €**
- **Republika e Kosovës 43 mln €**

Politika dhe vendimmarrja e centralizuar dhe vertilake, pa borde transparente, në mungesë totale të reformave apo miratimit të ligjeve të premtuar i ka bërë institucionet publike të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore më të varuara ndaj pushtetit, më hermetike ndaj individit krijues apo punonjësve të tjerë në fushën e artit e kulturës dhe si rrjedhojë më pak efikase. Këto institucione jo vetëm që nuk gjenerojnë dot të ardhura nga të tretët, por sot këto institucione nuk përdorin dot as të ardhurat nga biletat, një

e drejtë që është sanksionuar me "Ligjin për Artin dhe Kulturën" Nr.10352, datë 18.11.2010.

Po kështu vendimet arbitrare dhe të pakonsultuara me palët e interesit (në këtë rast me gjithë spektrin e artistëve dhe krijuesve) si mbyllja e Qendrës Kombëtare Artit dhe Kulturës, mbyllja e ekspozitës ndërkombëtare "Onufri" një traditë 20-vjeçare në artet pamore apo ndërprerja, me arsye se do të rikonceptohej, pas dhjetë vjetësh traditë i Festivalit të Regjisorëve të Rinj, janë vetëm disa nga hallkat që u këputën në vitin 2013 në dinamikën zhvilluese për krijimin e tregut të artit e kulturës, i cili është i pazëvendësueshëm për rankimin e produktit artistik në bazë të vlerës dhe konkurrueshmërisë. Referuar programit "Kultura për Shqipërinë krijuese" 2013, vërejmë se disa nga premtimet ishin:

Rishikim dhe hartim në Standardet Europiane të paketës ligjore që përfshin:

- *Ligjin për Krijimtarinë,*
- *Ligjin për Sponsorizimet dhe*
- *Nxitësit Fiskalë,*
- *Statuset Specifike (për secilin institucion të krijimtarisë),*
- *Kontratën Kolektive,*
- *Kontratën Individuale, etj.*

Dështim në hartimin e paketës ligjore. Në dy mandate qeverisë, në më shumë se shtatë vjet kjo qeveri nuk arriti të miratojë asnjë paketë ligjore që mbron dhe standartizon të drejtat e individit krijues, asnjë ligj për krijimtarinë, nxitësit fiskalë apo hallka të tjera që do të

çlironin këtë sektor nga centralizimi, për të dhënë mundësi punësimi për artistët, krijuesit dhe punonjësit e tjerë në fushat e artit dhe krijimtarisë, për të nxitur një treg konkures, të drejtë ku produkti kulturor dhe kreativ të vlerësohet mbi cilësinë. Përkundrazi, si rezultat ndryshimeve në politikën fiskale prej shtatë vitesh çdo krijues, shkrimtar, përkthyes, artist i arteve pamore apo skenike, çdo punonjës i lirë në fushën e artit paguan tatimin në burim mbi të ardhurat në masën 15%, shumë e cila peshon rëndë në fondet dhe buxhetet e siguruara me shumë vështirësi. Përmendim këtu se të gjithë këta artistë, krijues apo punonjës në industrinë kreative që paguajnë taksa e detyrime për çdo fond që arrijnë të sigurojnë, në këtë periudhë të vështirë, të detyruar të mos punojnë për shkak të pandemisë COVID-19, nuk kanë marrë deri tani asnjë ndihmë, asnjë lehtësi fiskale apo mbështetje financiare nga qeveria.

Industria e librit, në të gjitha hallkat, krijim, botim, shpërndarje ka vuajtur rëndesën e taksave dhe mungesën e komunikimit për të lehtësuar këtë sektor, i cili përtej humbjes së atyre që meren me këtë biznes, për vetë natyrën specifike të tij, humbësja e vërtetë është kultura.

Fondi i Bibliotekës Kombëtare u dëmtua nga ndërhyrja agresive në Sheshin Skënderbej, dëm për të cilin edhe sot nuk ka transparencë. Ndërkohë po përgatitet një tjetër projekt për zhvendosjen e këtij institucioni në mungesë të inventarizimit të fondit gjë e cila do të sillte dëmtimin apo zhdukjen e ekzemplarëve të rrallë të

trashëgimisë së mendimit. Rrjeti i bibliotekave, qoftë atyre që varen nga pushteti lokal, qoftë rrjeti i bilbliotekave në varësi të institucioneve të arsimit parauniversitar janë larg përditësimit me tregun e botimeve, mungojnë fondet e akorduara për këtë qëllim apo ndërhyrja me politika lehtësuese për furnizimin e tyre me tituj të rinj që nxisin lexuesin, e veçanërisht lexuesin e ri për të qenë më pranë librit.

Dështime të tjera të tjera që faktojnë se platforma "Shqipëria krijuese" ishte vetëm një premtim elektorale janë:

- Rigjenerimi i institucioneve kulturore
- Hapja e Shkollës së Cirkut pranë Liceut Artistik
- Hapja e degës së dramës AA në Shkodër.
- Krijimi i Studios Eksperimentale në TKOB
- Status i veçantë për Teatrin e Shkodrës dhe të Korçës
- Rikonceptim i Festivalit të Përvitshëm për Regjisorët e Rinj
- Rikonceptim i Festivalit Ndërkombëtar të Butrintit
- Hapja e dy teatrouve të reja për fëmijë në periferi të kryeqytetit
- Vendosja e Qendrës Kombëtare Multifunkionale për Fëmijë në ambiente të reja.

Asgjë nga këto nuk ka ndodhur, asnjë premtim nuk u mbajti dhe vendimmarrja politike nuk pati si parakusht premtimet dhe projektet për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, por axhenda personale në themel të së cilave qëndrojnë skema korruptive.

Si rezultat i kësaj vendimmarrje sot kemi dëme të pakthyeshme në objekte të rëndësishme trashëgimisë kulturore. Megjithatë në të dy programet edhe në vitin 2013 edhe në vitin 2017 ishte premtuar:

"Rikonstruktiv tërësor i Teatrit Kombëtar sipas standardeve europiane",

kjo ndërtesë u shemb përmes dhunës, terrorit dhe paligjshmërisë duke dokumentuar qartë se shteti është vënë në shërbim të krimit e mafies, por edhe duke shpërfillur organizata prestigjioze që mbrojnë dhe vlerësojnë trashëgiminë kulturore si Europa Nostra dhe partnerët ndërkombëtarë të cilët vazhdimisht ngulën këmbë për dialog dhe zgjidhje institucionale.

Po kështu, stadiumi Kombëtar Qemal Stafa u shemb në paligjshmëri të plotë, pasi vendimi për shembjen dhe akti i shembjes u kryen kur ishte ende objekt brenda zonës së mbrojtur, apo dhe ndërhyrje të tjera në qendrën historike të Tiranës si ndërhyrja në Sheshin Skënderbej, dëmtimi pamor i Kullës së Sahatit, kanë ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme perspektivën pamore të Bulevardit

Dëshmorët e Kombit, duke humbur vlerat funksionale, arkitekturore dhe historike të tij.

Urbicidi i ndodhur në Tiranë, në Durrës ku një pjesë e projektit 'Veliera' u ndërtua mbi rrënojat arkeologjike, por edhe në disa qytete të tjerë si pjesë e projektit "Rilindja Urbane", kanë dëmtuar rëndë gjurmët historike, kujtesën dhe objekte vlerë të trashëgimisë kulturore.

Edhe ato pak objekte të trashëgimisë kulturore kryesisht të kultit fetar që arrijnë të restaurohen apo shpëtojnë riskut të shëmbjes, ruhen nën projekte që financohen apo monitorohen nga organizmat ndërkombëtarë si: UNESCO, Bashkimi Europian, dhe patnerë të tjerë ndërkombëtarë, etj.

Ndëshkueshmëria ndaj agresionit të treguar këto vite kundrejt objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike është premtim dhe fillimi i një projekti të ri që kujdeset, ruan, kultivon dhe përcjell në të ardhmen artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore dhe historike duke filluar nga kultura e zbatimit të ligjit.





PROGRAMI KOMBËTAR AKT 2%

PREMTIMI

AKT **premtimi** se arti, kultura dhe trashëgimia kulturore në vizionin tonë të qeverisjes do të qëndrojnë përtej dhe mbi politikën, duke i shërbyer mirëqenies, tolerancës dhe duke kontribuar në artin e të jetuarit së bashku.

VENDIMARRJE

AKT **vendimarrje** mbështetur mbi filozofinë se përmes zhvillimit të artit e kulturës, përmes mbrojtjes së trashëgimisë së kulturës, pasurisë së mendimit dhe ruajtjes së identitetit tonë kombëtar, kulturor dhe historik, formësojmë projektimin tonë social në të ardhmen si individë, si shoqëri, si komb.

BESIMI

AKT **besimi** se arti, kultura dhe trashëgimia kulturore përmes investimit, rikonceptimit e reformimit të thellë strukturor dhe funksional të institucioneve, përmes hartimit të mjedisit ligjor që vendos në zbatim mekanizmat e konkurueshmërisë, nxit lirinë krijuese dhe vendos standarte që garantojnë cilësi, mund të kthehen në një industri kreative me ndikim të rëndësishëm shoqëror dhe ekonomik.





PARIMET MBI TË CILAT ËSHTË HARTUAR PROGRAMI KOMBËTAR AKT 2%



- decentralizimi
- depolitizimi
- dimensioni ekonomik i kulturës
- ekuilibër mes investimit në kulturën statike dhe asaj dinamike
- kultura si e drejtë humane
- promovimi i identitetit kulturor të komuniteteve
- konteksti europian



3. Parimet mbi të cilat është hartuar Programi Kombëtar AKT 2%

Pas një analize të detajuar të faktorëve socialë, ekonomik dhe politik të cilët ndikojnë në mënyrë direkte ose indirekte ruajtjen, krijimin apo lëvrimin e kulturës dhe artit në Shqipëri, Programi Kombëtar AKT-2% u hartua si domosdoshmëri për ndryshim të thellë e reformues, i konceptuar për një zhvillim cilësor dhe të qëndrueshëm në fushën e artit dhe të kulturës dhe u ndërtua mbi këto parime:

3.1 Decentralizimi

në shërbim të një shpërndarje bazuar në parime demografike të produktit kulturor drejt periferisë, zonave urbane e rurale dhe gjithashtu në përfshirje të individit krijues në po të njëjtat zona periferike dhe urbane.

3.2 Depolitizimi

i administratës në institucionet kulturore në nivel qendror dhe lokal si një garanci në miradministrim dhe mirmenaxhim drejt zhvillimit cilësor të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

3.3 Dimensioni ekonomik i kulturës

produktet dhe shërbimet e gjeneruara nga aktivitete dhe industri kulturore duhen vlerësuar si një vektor i fuqishëm për zhvillimin shoqëror dhe kulturor për shkak të natyrës së tyre të dyfishtë si ekonomike ashtu edhe kulturore.

3.4 Ekuilibër në investimin publik mes kulturës statike dhe asaj dinamike

kultura statike, pra trashëgimia kulturore, historike dhe trashëgimia e mendimit padyshim përbën një element krenarie dhe vlerë kombëtare për atë çfarë ne përfaqësojmë kulturalisht, por kjo nuk duhet të kushtëzojë dhe pasvendosë në investimet publike kulturën dinamike, pra industrinë kreative dhe artin bashkëkohor duke kushtëzuar projektimin tonë kulturor dhe social në të ardhmen.

3.5 Kultura si e drejtë humane

në përputhje me Nenin 27- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut: "Çdokush ka të drejtën të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit, të shijojë artet. Çdokush ka të drejtë për mbrojtjen e interesave morale dhe materiale që rezultojnë nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik, autor i të cilit është."

3.6 Promovim dhe hapësirë për identitetit kulturor të minoriteteve

diversitetet kulturore nuk duhet të na ndajnë nga njëri-tjetri, përkundrazi, bashkëjetesa harmonike mes kulturave, traditave, trashëgimisë, besimeve, gjuhëve është parakushti për kohezion social në vizionin tonë të qeverisjes.

3.7 Konteksti europian

promovimi i kulturës si "shpirti i demokracisë" nënkupton mbështetjen dhe nxitjen e politikave të forta kulturore dhe një qeverisje që synojnë transparencë, akses, pjesëmarrje dhe krijimtari, respektimi i identitetit dhe diversitetit, dialogu ndërkulturor dhe të drejtat kulturore si bazë për të jetuar së bashku në harmoni dhe tolerancë në një botë gjithnjë e më komplekse.

“Kultura i bën njerëzit të kuptojnë më mirë njëri-tjetrin. Dhe nëse ata e kuptojnë më mirë njëri-tjetrin në shpirtin e tyre, është më lehtë të kapërcehen barrierat ekonomike dhe politike.”

~ Paulo Coelho ~



“Njeriu është një qenie kulturore, ndaj mënyra si i konceptojmë, përvetësojmë, promovojmë dhe investojmë në art, kulturë apo trashëgiminë e kulturës dhe të mendimit, tregon shkallën e civilizimit së cilës i përkasim si individ, si shoqëri dhe si komb.

4. Vizioni

Programi AKT✓2% është një projekt hartuar mbi vizionin e qartë se arti kultutura dhe trashëgimia kulturore janë kontributorët më të vlefshëm për një bashkëjetesë dhe kohezionin social si themel i mirëqenies, edukimit dhe zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.


5. Misioni

Programi AKT✓2% ka misionin të rikonceptojë, reformojë dhe të ndryshojë rrënjësisht infrastrukturën ligjore dhe institucionale, mekanizmat mbi të cilat funksionin arti, kultura, apo mbrohet, restaurohet, promovohet dhe përcillet trashëgimia kulturore dhe pasuria e mendimit.

6. Qëllimi Strategjik

Programi AKT✓2%, ka si qëllim strategjik të rrisë në mënyrë progresive buxhetin për kulturën deri në nivelin 2% të buxhetit të shtetit. Programi AKT✓2% synon përmes rritjes së investimit publik, të ktheje artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore në një industri kreative funksionale, të integruar dhe konkurruese, jo vetëm me impakt social por edhe ekonomik.





7. OBJEKTIVAT POLITIKE TË PROGRAMIT KOMBËTAR AKT 2%

7.1 Art dhe kulturë e aksesueshme për këdo,
jo vetëm si një drejtë humane, por si një faktor
themeltar për një shoqëri më të shëndetshme,
më tolerante dhe gjithpërfshirëse.



OBJEKTIVAT POLITIKE

7.2 Një gjuhë, një kulturë, një komb.

Një komb nuk përcaktohet nga kufijtë e tij tokësorë, apo nga madhësia e shtrirjes gjeografike. Përmasa e një kombi është pasuria e mendimit, kulturës dhe historisë, është tërësia e vlerave që përcaktojnë identitetin kombëtar.

Historia e treguar e padrejtë ka luajtur idhshëm në kurriz kombit shqiptar duke e ndarë, gjymtuar dhe vendosur kufij. Por sot ata kufij nuk duhet dhe nuk mund të ndajnë kulturën, gjuhën, traditën, pasurinë historike dhe trashëgimin e mendimit tonë kombëtar.

Gjuha shqipe është indi që mban lidhur themelin e identitetit tonë kombëtar, por ruajtja, kultivimi, zhvillimi i saj është përcaktuar nga pasuria e mendimit, potenciali intelektual, është përcaktuar nga kultura, tradita, besimi dhe vlerat mbi cilat ky komb ka ngritur dhe siguruar ekzistencën e tij.


Të vetëdijshëm se nuk mjafton vetëm artikulimi, vetëm dëshira dhe mendimi për të qenë bashkë, por është vendimarrja e përbashkët me një vizion të ri drejt unifikimit të mendimit dhe kulturës kombëtare, parakushti për përmasën dhe vetëdijen e një kombi që faktorizon paqen dhe stabilitetin në rajon dhe aspiron integrimin në Bashkimin Europian.

Një program mbarkombëtar mbështetur mbi politika dhe vendimarrje të përbashkët me qeverinë e Kosovës, për zhvillimin dhe bashkëpunim në fushën e artit dhe kulturës, gjuhës dhe edukimit, ruajtjes e promovimit të trashëgimisë kulturore dhe historike, për unifikimin e mendimit tonë kombëtar, është hapi i parë për jetësimin e misionit historik dhe objektivit tonë politik drejt një bashkimi (unifikimi) kulturor kombëtar "Një gjuhë, një kulturë, një komb".

Kombi shqiptar ka të gjithë potencialin të vendosë për fatin dhe të ardhmen e tij, ndaj krijimi i një hapësire të përbashkët dhe të unifikuar të kulturës, gjuhës dhe mendimit shqip në rajonet shqipfolëse, është sot një detyrim që ngrihet mbi sakrificat, qëndresën e këtij kombi dhe ka të gjithë vullnetin politik në vizionin tonë qeverisës.

7.3 Komunizmi në kryqëzimin mes kujtesës dhe historisë, të vërtetës dhe interpretimit.

Kujtesa historike karakterizohet nga ndryshimi i vazhdueshëm i kontekstit historik. Konstruktimi historik bazohet mbi faktet historike por edhe në rekonstruimin njerëzor referuar kujtesës, kur kjo është e mundur. Por nëse për këtë rikonstruim historik për të ndërtuar të kaluarën objektive të komunizmit në Shqipëri, nuk ka transparencë, nuk ka ballafaqim me të vërtetën, nuk ka përballje shkencore dhe emocionale, me një prej diktaturave më të egra, kemi dështuar si shoqëri dhe thelbësisht diçka nuk ka shkuar siç duhet në procesin e ballafaqimit tonë me të shkuarën diktatoriale. Interpretimi i artefaktit historik me qëllim manipulimin e perceptimit për krimet, vrasjet dhe genocidin gjatë periudhës së komunizmit, ringjallja e simboleve dhe figurave të diktaturës totalitare komuniste në Shqipëri, bazuar në një nxitje dhe dakordësi shtetërore në veprimtari zyrtare publike gjatë qeverisjes së majtë, është shkelje e parimeve



dhe angazhimeve europiane për dënimin e komunizmit, po kështu një provokim i rëndë dhe i papranueshëm ndaj ndërgjegjes shoqërore në tërësi dhe viktimave të regjimit komunist në veçanti.

Zhvillimet politike dhe shoqërore të 30 viteve të tranzicionit, me gjithë kohën e konsiderueshme që ka kaluar prej rënies së

komunizmit, kanë penguar nxjerrjen e plotë të të vërtetës mbi krimet e komunizmit në Shqipëri, si dhe dënimin e ideatorëve, organizatorëve dhe zbatuesve të drejtëpërdrejtë të regjimit diktatorial. Akti i fundit me të cilin parlamenti ilegjitim u mohoi shqiptarëve, akademikëve dhe hulumtuesve të të gjitha fushave të drejtën për studimin dhe njohjen e historisë së krimeve të

komunistëve ndaj shqiptarëve në periudhën 1941-1945, është tregues i qartë i përpjekjes për të fshehur të vërtetën dhe manipuluar historinë.

Në Shqipërinë e vitit 2020, 30 vite pas rënies së komunizmit nuk ka një datë zyrtare për të kujtuar viktimat e komunizmit, nuk ka një mur të kujtesës, nuk ka një muze që dokumenton pa emfatizim dhe rijetëzon terrorin që

përjetuan viktimat, të burgosurit, internuarit dhe familjarët e tyre. Komunizmi nuk ishte një etapë historike, ishte një zgjedhje e gabuar, në anën e gabuar të zhvillimit historik të njerëzimit, pasojat e të cilës i vuajtën mijëra viktima, mijëra të burgosur dhe të internuar politik. Nëse njohim viktimat duhet të njohim dhe dënojmë qoftë edhe moralisht, edhe persekutorët. Ky është një

detyrim moral ndaj viktimave të genocidit në periudhën e komunizmit që kërkon sot më shumë se kurrë një angazhim gjithpërfshirës dhe vullnet, jo vetëm politik. Transparenca dhe një raport i drejtë me të vërtetën përmes edukimit, kulturës dhe artit është një premtim i Partisë Demokratike për ndërgjegjësimin kombëtar mbi krimet e regjimit komunist për periudhën 1941-1991. parime:

Partia Demokratike përmes Pogramit Kombëtar AKT 2% , për të realizuar objektivin e saj politik për një reflektim social për "Komunizmin në kryqëzimin mes kujtesës dhe historisë, të vërtetës dhe interpretimit" do të realizojë:

- Ngritjen e memorialit për viktimat e komunizmit.
- Ndërtimin e objektit muzeal "Muzeu i Terrorit"
- Vendet e kujtesës me impakt social shpallen zona a parqe të trashëgimisë kulturore dhe asaj historike, në mënyrë që të mbrohen nga çdo lloj ndërhyrje.
- Nxitjen e krijimtarisë në letërsi, muzikë dhe arte të tjera të performuara, bazuar në hulumtimin e fakteve historike për krimet e diktatures dhe pasojat e saj. Decentralizimi mbi të drejtën për hulumtim të institucioneve dhe individëve do të jetë një mbështetje e rëndësishme që krijimtaria të shmangë fabrikimin e kujtesës dhe të ngrihet e ndëtohet mbi fakte dhe ngjarje realisht të ndodhura.
- Përfshirjen në programet e edukimit kulturor, seksione të dedikuara për memorien dhe historinë në lidhje me faktet dhe të vërtetat mbi dhunën dhe terrorin gjatë periudhës së dikaturës në Shqipëri.



Nëse nuk njohime të shkuarën nuk mund të perceptojmë as të tashmen dhe as e ardhmen e një shoqërie. Të tria kohërat kanë rëndësi vendimtare për fatet e një individi dhe një kombi.



7.4 Integrimi i Shqipërisë përmes artit, kulturës

Shqipëria ka një rrugë të gjatë për të bërë drejt integrimit në Bashkimin Europian, i cili është proces i gjatë, politik, ekonomik, juridik, teknik, por mbi të gjitha është një proces kulturor, i cili është momenti të vlerësohet maksimalisht.

Përmes programit AKT 2% ne vlerësojmë integrimin kulturor të Shqipërisë, si një proces të mundur, të duhur dhe të nevojshëm. Promovimi i vlerave tona më të mira të trashëgimisë kulturore, krijimtarisë dhe kulturës sonë dinamike përmes një bashkëpunimi kulturor kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar është diplomacia më e mirë drejt integrimit të Shqipërisë dhe kombit shqiptar në Bashkimin Europian.







8. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË PROGRAMIT KOMBËTAR AKT 2%





- Një **“Ligji i ri për Artin, Kulturën dhe Krijimtarinë”** i cili reflekton me kuadër të plotë ligjor rikonceptimin, rithemelimin apo shndërrimin e statuseve të institucioneve të artit dhe kulturës në nivel qendror e lokal, gjithashtu rregullon marrëdhëniet e infrastrukturës dhe faktorëve të tjerë të industrisë kreative publike apo private.
- **“Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejta të tjera të lidhura me të”** i cili kërkon plotësimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore me qëllim një mbrojtje më të madhe të të drejtave autoriale dhe pronësisë intelektuale.
- Ligji nr 35/2016 **“Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”** në tërësinë e tij është ligj që duhet të ketë të transpozuar direktivat e BE dhe në tërësi i ka të përfshira këto direktiva, por konstatohet se ka ndërhyrje në to, duke devijuar disa nga parimet kryesore dhe duke tentuar shtetëzim të organizimeve private, me ndërhyrje të drejtpërdrejtë të shtetit. Në tërësi, përsa i takon nivelit të zbatimit të këtij ligji, indikatorët tregojnë se jemi në më pak se 1% zbatueshmëri të tij, përsa i takon veprave muzikore dhe audiovizuale dhe në një fashë disi më të lartë, por sërish larg nivelit të zbatimit në vendet e Bashkimit European përsa i takon librit, veprat e arteve të bukura si edhe programet kompjuterike e bazat e të dhënave. Aktualisht në tregun e industrive kreative, të ardhurat bazuara në të drejtën e autorit gjenerojnë në ekonomitë vendase nga 11% të GDP në SHBA, deri në 5–7% në vendet e Bashkimit European. Objektivi ynë është që të krijojmë kushtet për krijimin, forcimin dhe formalizimin e industrive krijuese, duke i parë ato si një mekanizëm ekonomik , i cili prodhon të ardhura për krijuesit dhe artistët dhe nxit punësimin në fushën e artit dhe kulturës.
- Ndryshime ligjore të cilat të sjellin përputhshmërinë e tij të plotë me direktivat si edhe me legjislacionin e brendshëm, duke garantuar pavarësinë e organizimit të organizatave private të titullarëve të të drejtave.



- Miratimin e akteve ligjore të mbajtura pezull prej 4 vitesh nga qeveria aktuale, sic është "Vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave të kopjes private", një mekanizëm, i cili në mënyrë të menjëhershme dhe mbi baza vjetore, sjell të ardhura të drejtpërdrejta tek autorët dhe artistët e muzikës e veprave audiovizuale si dhe tek titullarët e tjerë të të drejtave, siç janë shkrimtarët, shtëpitë botuese, prodhuesit e fono-videogram si edhe piktorët.
- Roli aktiv i shtetit, për titullarët e të drejtave dhe komunitetin e autorëve, krijuesve dhe interpretuesve, nëpërmjet fuqizimit të mekanizmave institucionalë të zbatimit të ligjit, duke koordinuar punën me Ministrinë e Kulturës, AMA, AKEP, DPT, DPD, DPP, Inspektoriatin i Tregut dhe AAK dhe titullarëve të të drejtave të autorit, me qëllim zbatimin e "Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejta të tjera të lidhura me të" në të gjithë territorin dhe rritjen e masës së shpërblimeve që vijnë nga ky ligj si burim alternativ të ardhurash për komunitetin e autorëve dhe artistëve e titullarëve të tjerë të të drejtave.


Gjithashtu krahasuar me vendet rajonit, në vëzhgim të disnivelit të të ardhurave që gjenerohen nga ky ligj kemi të dhënat si më poshtë:

- **Republika e Serbisë – 6 mln banorë referon vetëm arkëtime nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv rreth 13mln € /vit**
- **Republika e Kroacisë me 4mln banorë referon rreth 20 mln €/vit**
- **Ndërsa Shqipëria raporton të ardhura nga Agjencitë vlerën 0.4mln€/vit**
- Ligjit për Statuset dhe Pensionet e Profesioneve të vështira, i cili trajton specifikisht kërkesat e artistëve dhe uljen e moshës së pensionit për disa kategori të punonjësve, në fusha të ndryshme të artit.
- Krijimi i Regjistrat Kombëtar të Artistëve të Pavarur i cili është një domosdoshmëri dhe rregullon funksionimin e tregut të artit dhe kulturës, sistemon marrdhëniet individ-shtet në çdo sektor të kulturës.

- **Ligji për Sponsorizimet dhe Nxitësit Fiskalë**, plotësimi i tij me kornizën e duhur ligjore për ta bërë më fleksibël dhe funksional me qëllim forcimin, fuqizimin dhe çlirimin e tregut të artit dhe kultuës si dhe nxitjen e filantropisë.
- Reformimi i **"Ligjit për Kinematografinë"** duke krijuar mundësitë përmes politikave dinamike të stimulojë sektorin kinematografik për bashkëprodhim me kompani të huaja, me fokus në fuqizimin e sektorit vendas dhe atë kombëtar në rajonin e Ballkanit. Hartimimi i një kornize ligjore që siguron miradministrimin e fondeve publike, nëpërmjet aplikimit të procedurave më transparente në procesin e seleksionimit, vlerësimit dhe financimit të projekteve kinematografike. **"Ligji për Kinematografinë"** duhet të reflektojë qartësi për t'i paraprijë përballjes së produktit kinematografik shqiptar me platformat multinationale Netflix, Amazon etj, duke rritur impaktin ekonomik të produktit të industrisë kinematografike. Krijimi i mekanizmave për një bashkëpunim më efektiv të kompanive dhe enteve kinematografike të komuniteteve shqipfolëse si një angazhim për rritjen e impaktit, prezencës dhe ndikimit të produktit kinematografik kombëtar në rajonin e Ballkanit dhe në Bashkimin Europian.
- Pasuria kulturore, trashëgimia e tërësisë së vlerave materiale dhe jo materiale të kulturës statike që indentifikon prejardhjen, historinë dhe vlerat kulturore kombëtare, kërkojnë një mjedis më të qartë dhe më të thjeshtë ligjor referuar këtu **"Ligjit Nr. 27/2018 Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"**. Zbatimi i mekanizmave funksionalë me qëllim ruajtjen, promovimin dhe veçanërisht miradministrimin e qëndrueshëm e transparent të pasurive të trashëgimisë kulturore, muzeale dhe arkeologjike kombëtare duke rivlerësuar skemat e aplikuara deri tani në menaxhimin e tyre. Mekanizmat promovues për të prezantuar dhe vërtetuar origjinalitetin e kulturës, vlerat dhe trashëgiminë kombëtare në bashkëpunim me projektet e Bashkimit Europian, UNESCO-s dhe organizmave të tjera, do të jetë një mision në projektet për integrimin kulturor të Shqipërisë në familjen europiane.
- Krijimi i një strukture këshillimore dhe ekspertize me profesionistë të fushës për certifikimin dhe standartizimin e restaurimeve të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, referuar standarteve të Bashkimit Europian.
- Rishikimi i listës së Parqeve Kombëtare Arkeologjike dhe listës së Monumenteve të Kulturës sipas kategorive përkatëse, duke synuar rifutjen në këto lista të të gjitha atyre objekteve me vlerë historike dhe arkitekturore të cilat qëllimshëm kanë mbetur jashtë zonave të mbrojtura, por fatmirësisht deri tani i kanë shpëtuar shëmbjes duke krijuar disa qendra të mbrojtura historike më të vogla.

8.2 Rishikim të politikës fiskale në të gjithë spektrin e industrisë kreative, duke filluar që tek industria e botimeve, artet pamore, artet e performuara, kinematografia e deri individi krijues dhe operatorët privat, për të çliruar tregun dhe për ta bërë produktin e krijimtarisë më konkurrues dhe të lëvizshëm në rajon dhe përtej. Arti, kultura dhe trashëgimia kulturore duhet dhe mund të zhvillohen e shndërrohen në një industri kreative me impakt social dhe ekonomik vetëm nën një politikë fiskale më tolerante, më frymëdhënëse duke i konsideruar si një prioritet kombëtar. Zbatimi i politikave fiskale të cilat kanë si synim fuqizimin e individit, çlirimin dhe forcimin e tregut, në vizionin tonë të qeverisjes janë mekanizmi i duhur për të përfituar ndryshime cilësore dhe një zhvillim të qëndrueshëm në industrinë kreative në Shqipëri.

- Një qasje dhe politikë fiskale më tolerantë fillon me uljen e tatimit në burim mbi të ardhurat në masën 15% për të gjithë spektrin e industrisë kreative.
- Rishikimi dhe rikonceptimi fiskal në industrinë kinematografike duke aplikuar një politikë dinamike të kombinimit efektiv të **tax-incetives/tax-rebates** me **Film Comissions** për promovimin e territorit, hospitalitetin si edhe kontribute shtese nga pushteti lokal e qendror, me synim shndërrimin e Shqipërinë në një atraksion për prodhimet dhe distribucionet ndërkombëtare të industrisë kinematografike.
- Rivlerësimi i barrës fiskale, thjeshtimi apo unifikimi i taksave të aplikuara në hallka të ndryshme të industrisë së botimeve është një ndërhyrje e domosdoshme për të ndryshuar dhe përmirësuar produktin final të kësaj industrie: librin. Industria e botimeve, veçanërisht botimet letrare dhe botimet që kanë lidhje me edukimin duhet të mbështeten me politika të tjera lehtësuese, për karakterin elitare që kanë si sipërmarrje dhe për rëndësinë jetike që kanë për arsimin, edukimin dhe kulturën.



“ Art dhe kulturë e aksesueshme për këdo, jo vetëm si një drejtë humane, por si një faktor themeltar për një shoqëri më të shëndetshme, më tolerante dhe gjithpërfshirëse.

- **8.3 Krijimi dhe themelimi i institucioneve të reja, rikonceptimi dhe ristrukturimi i institucioneve ekzistuese nga ana ligjore dhe infrastrukturore si domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e artit kulturës dhe trashëgimisë kulturore.**
- Reformimi i thellë funksional i institucionve të artit dhe kulturës për të siguruar suksesin e programit AKT-2%, do të jetë faza e parë e zbatimit të këtij programi. Këtij reformimi apo rikonceptimi do t'i nënshtrohen institucionet e artit dhe kulturës në varësi të pushtetit qendror dhe atij vendor por në krye të çdo premtimi do të qëndrojë :



Rindërtimi i Teatrit Kombëtar, aty ku ishte, ashtu si ishte.

- Rikonceptim në infrastrukturën funksionale të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit referuar modeleve europiane, për ta kthyer këtë institucion në prodhues të një produkti artistik që përfaqëson vlera ë vërteta dhe kulturë të një kombi të qytetëruar. Modeli i operas gjermane do të ishte i zbatueshëm dhe funksional dhe garantues për këtë reformim.
- Teatri Kombëtar i Operas do të mirëpresë në organikën e tij sipas kriterëve profesionalë dhe artistik këngëtarët lirikë të Kosovës, në bazë të një marrëveshje mes dy qeverive, derisa Kosova të ketë Teatrin e Operas.
- Reformim i teatrove duke synuar një ndryshim thelbësor nga mënyra si funksionojnë këto institucione sot në Shqipëri. Në përputhje me parimin e decentralizimit dhe qëllimit tonë politik "Art dhe kulturë e aksesueshme për këdo, si një e drejtë humane", do të fitojnë statusin e teatrit kombëtar teatri:
 - **"Migjeni" Shkodër,**
 - **"Andon Zako Çajupi" Korçë**
 - **"Petro Marko" Vlorë.**
- Bashkëpunim më organet e pushtetit vendor për reformim gjithashtu të teatrove bashkiake. Mbështetur mbi kornizën ligjore të "Ligji i ri për Artin, Kulturën dhe Krijimtarinë" teatrot shndërrohen në fondacione, një model që vendos në funksion mekanizma të balancuar menaxhimi dhe i jep liri institucioneve të artit si teatrove, muzeumeve dhe galerive, të rritin të ardhurat përtej fondeve publike të akorduara nga buxheti i shtetit dhe të integrohen në një treg ku konkurueshmëria e produktit është motorri që lëviz çdo mekanizëm.
- Qëllim strategjik i Programi Kombëtar AKT-2% dhe padyshim një sfidë janë investimet kapitale në të gjitha institucionet kulturore të varësisë, ndërhyrjet infrastrukturore, rindërtimet dhe përditësimin e pajisjeve të teknologjisë sipas standardeve moderne, në përshtatje të funksionit të institucioneve për një performacë më konkurruese drejt tregut kulturor si brenda dhe jashtë vendit.

- Biblioteka Kombëtare përtej funksionit të saj në shërbim të komunitetit është i vetmi institucion që ruan trashëgiminë tonë të mendimit dhe të gjuhës si dëshmi e identitetit dhe kulturës sonë kombëtare. Biblioteka Kombëtare do t'i nënshtrohet një rikostruksioni të thellë për të mundësuar zgjerimin dhe shtimin me mjedise të reja e bashkëkohore dhe kushte të tjera të domosdoshme por veçanërisht zbatimin e një projekti kundra-zjarr sipas standerteve europine të bibliotekave. Po kështu digjitalizimi së bashku me një inventarizim të saktë dhe shkencor janë projekte të jetike për këtë institucion.
- Bibliotekat vendore dhe bibliotekat shkollore në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës do të investohen nga "Fondi i Veçantë për Librin" parashikuar si një vektor nxitës dhe ndërhyrje emergjente për përditësimin fondit të bibliotekave me botime dhe tituj sipas specifikave të tyre, për ta përafruar sa më shumë lexuesin, sidomos lexuesin e ri tek libri.
- Ndërtimi i rrjetit të librarive të qyteteve me siglën përkatëse në mbështetje të vizionit se shitja e librit nuk mund të konsiderohet si një biznes normal, ai është një biznes elitar që duhet të mbështetet nga pushteti lokal përmes lehtësimit të barrës fiskale. Tkurrja e këtij sektori në vitet e fundit ka vetëm një humbës, kulturën.
- Krijimi dhe themelimi institucioneve të reja të artit e kulturës statusi i të cilëve do të përcaktohet nga "Ligji i ri për Artin, Kulturën dhe Krijimtarinë" parathënia e për zbatimin dhe suksesin e AKT- 2%.
- **Qendrës Kombëtare të Artit Bashkëkohor (QKAB),**
- **Fondacioni për Letërsinë Shqipe**
- **Agjensia e Librit Shqip**
- **Teatri " RINART"-teatri për artistët e rinj të arteve të përformuara**
- **Teatri Alternativ**
- **Biblioteka e Tiranës**
- **Teatri Kombëtar i Kukullave**
- **Shkolla e Cirkut**
- **Shkolla e Restauratorëve**
(pranë Instituti i Monumenteve të Kulturës)
- **Drejtoritë Rajonale të Kulturës – të cilat do të kenë varësi të dyfishtë**



9. PROGRAMET MBËSHTETËSË NË REALIZMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR AKT✓2%

**THESARET
E SHQIPERISE**

**URAT E KULTURES
KOMBETARE**

**Mendje KURIOZE,
KRITIKE, KREATIVE**

ART-BANK

RINFOND



"THESARET E SHQIPERISE"

Program promovues të objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, trashëgimisë së mendimit, krijimet më të spikatura në fushën e krijimtarisë muzikore, letrare, arteve pamore. Projekt që do të materializohet me "eksportimin" e këtyre vlerave përmes botimeve, ekspozitave fizike dhe digjitale paraqitja në festvale dhe aktivitete ndërkombëtare.

"URAT E KULTURES KOMBETARE"

Platformë e veçantë që do të konkretizohet nga një vendimarrje e përbashkët me qeverinë e Kosovës por edhe me qeverirë e tjera të hapësirës shqipfolëse në rajonin e ballkanit.

"Mendje KURIOZE, KRITIKE, KREATIVE"-

Edukimi përmes artit, kulturës dhe memories historike është një project që i hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit synon të ofrojë një edukim interaktiv në sistemin parauniversitar, me ndryshime të kurrikulës ku është e nevojshme.

"ART-BANK"

Një program inovativ që synon përmes marrëveshjeve me bankat e nivelit të dytë angazhimin e tyre filantropik në promovimin dhe marrjen në patronazh të një muzeumi, galerie apo ekspozite.

"RINFOND"

Program që mbështetet nga një fond i dedikuar për artistët e rinj në të gjitha fushat e krijimtarisë, për të mundësuar kalimin e tyre nga shkolla drejt tregut të punës, promovimin dhe mundësinë e punësimit si artistë të pavarur.



10. SFIDAT

- Liberalizimi i tregut
- Artistët të marginalizuar
 - Kuota gjinore
 - Arti dhe kultura në epokën digjitale
- Punësimi i të rinjve



Liberalizimi i tregut dhe një ndarje më të ekuilibruar drejt invenstimit publik dhe privat, është një sfidë e cila kërkon iniciativa për krijimin e një tregu të konsoliduar dhe mekanizma për ta bërë këtë treg atraktiv për investimin privat, sponsorizimin dhe filantropinë.

Artistët të margjinalizuar - nëpërmjet krijimit të një fondi të posaçëm për artistë që vijnë nga familje të varfëra, artistë me aftësi ndryshe apo me aftësi të kufizuara, u krijohet mundësia për të çliruar talentet e tyre e për të ofruar dhe për të qenë të përfshirë më tepër në jetën sociale dhe kulturore.

Kuota gjinore - nënperfaqësimi i grave dhe vajzave në fushën e artit dhe kulturës, veçanërisht në target-grupin e artistëve të pavarur, për shkak edhe të specifikave dhe vështirësive që bart vetë fusha e artit dhe kulturës, kërkon aplikim e mekanizmave shtesë për të ruajtur një përfshirje më të drejtë të grave dhe vajzave në art dhe kulturë.


Punësimi i të rinjve

si një nga shtyllat e programit tonë politik punësimi i të rinjve edhe në fushën e artit dhe kulturës mbetet një sfidë jo vetëm për të rinjtë por edhe për institucionet që operojnë në fushën e artit, kulturës dhe edukimit. Mungesa e hapësirave në tregun e punës për artistët e rinj po demotivon kërkesën dhe cilësinë për studenë në Institucionet e Arsimit Lartë që ofrojnë studime në fushën e artit dhe kulturës.

Arti dhe kultura në epokën digjitale

– digjitalizimi në fushën e artit dhe të kulturës përtej zhvillimeve individuale, mbetet një sfidë për shkak se kërkon një rrjet software-sh të mirëstrukturuar dhe të dyanshëm, qoftë të krijuesit që digjitalizon objektin kulturor, qoftë të publikut që prek artin përmes procesit të digjitalizimit. Referuar edhe përvojës së vendeve të Bashkimit European apo edhe rajonit të ballkanit, digjitalizimi është një proces i domosdoshëm për ruajtjen dhe promovimin dhe lëvrimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, është një proces i cili ofron dhe paraqet tek publiku artin dhe kulturën në një formë jo tradicionale, duke e bërë më të lëvizshme, më komunikuese dhe më dinamike duke ndryshuar

DIGJITALIZIMI TRANSFORMON MENYRËN DHE HALLKAT E INDUSTRISE KREATIVE



DRAFT

AKT  2%

A_{RT} - K_{ULTURË} - T_{RASHËGIMI}

#2021-2025